



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Detyrimet kontingjente ishin nënvlerësuar për 459,386€ pasi që në regjistrin e tyre nuk ishin përfshirë të gjitha raportet nga njësitë vartëse të MASHTI-it;
- B1 Vlera e prezantuar në PFV për pasuritë kapitale ishte mbivlerësuar për 75,801€, si rezultat i mos bartjes së pasurive në regjistrat përkatës të shkollave/Komunave pas pranimi të pajisjeve dhe një pjesë të investimeve/blerjeve të vitit nuk kishte arritur t'i regjistronte; dhe
- B2 MASHTI në vitin 2023 (duke u bazuar në planifikimin buxhetor) ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 1,407,566€ në kategori ekonomike jo adekuate.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Vlerësimi i ofertave me vonesë dhe jo në përputhje me kriteret e vendosura në dosje të tenderit;
- A3 Angazhimi për shërbime të veçanta kontraktuese/intelektuale pa procedura të prokurimit; dhe
- A4 Mangësi në pranimin dhe pagesën e furnizimeve të shkollave me paisje të ndryshme.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

ZKA është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, ZKA është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria në vitin 2023 ka shpenzuar 87% të buxhetit final, me një rritje prej 2% në krahasim me vitin 2022. Në kontekst të sistemeve financiare fushat ku janë identifikuar mangësi më të theksuara kanë të bëjnë me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, nënvlerësim të detyrimeve kontigjente, mangësi në menaxhimin e proceseve të prokurimit, mbajtje të avanceve të hapura për projekte kapitale dhe mangësi në procedimin e pagesave. Më tutje, pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet në regjistrat kontabël dhe si rezultat i gabimeve si dhe mos harmonizimit vjetor kemi mbivlerësim të pasurive. Po ashtu, bartja e objekteve arsimore të cilat ishin në përdorim nga Komunitat përkatëse kishte filluar por që ende mbetet sfidë e Ministrisë për finalizimin e këtij procesi.

Kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi funksiononin në mënyrë efektive.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, tri (3) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht të përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Nënvlërësimi i detyrimeve kontigjente

Gjetja

Bazuar në Rregulloren MF nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore (OB), OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Sipas nenit 18 të kësaj rregullore OB-të duhet të raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Në identifikuar që në PFV-të e vitit 2023, detyrimet kontigjente të Universitetit të Pejës, Ferizajit, Gjakovës dhe Prizrenit nuk ishin prezantuar kurse ato të Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional ishin prezantuar pjesërisht. Listat e detyrimeve kontigjente që kemi pranuar nga këto programe kishin vlerën 459,386€, po ashtu në këtë listë kishte raste kur ato ishin të paguara me vendime të gjykatave dhe figuronin si detyrime kontigjente.

Kjo kishte ndodhur për shkak mungesës së koordinimit dhe komunikimit të duhur të zyrtarëve përgjegjës të njësive vartëse me zyrtarët e administratës qendrore dhe nga pakujdesia për largimin e lëndëve që janë paguar.

Ndikimi

Prezantimi jo i plotë dhe i saktë i detyrimeve kontigjente ndikon që PFV-të të mos prezantojnë gjendjen e saktë dhe vlera e tyre financiare të nënvlerësohet, përderisa mos azhurnimi i regjistrat të detyrimeve kontigjente nga lëndët e paguara ndikon që vlera e tyre financiare të mbivlerësohet.

Rekomandimi A1

Ministrja, duhet të siguroj një koordinim dhe komunikim të duhur në mes zyreve ligjore të të gjitha njësive vartëse dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mbivlerësimi i pasurive kapitale dhe jo kapitale**Gjetja**

Sipas nenit 13, pikave 1 dhe 2 të rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare, të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim dhe në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim, kurse neni 3 përcakton që njëri nga kriteret për ta njohur një pasuri kapitale apo jo kapitale është që pronësia dhe kontrolli i përfitimeve të mbetet te organizatat buxhetore që i mbanë ato.

Po ashtu, neni 11, pika 2 thekson që pasuritë jo financiare kapitale që janë në fazën e investimeve në vijim nuk zhvlerësohen, kurse neni 6, pika 3 thekson që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa ajo jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria.

Në PFV identifikim që MASHTI gjatë vitit 2023 kishte nënvlerësuar pasuritë në vlerë 75,801€ që kishin të bënin me çështjet në vijim:

- MASHTI pajisjet e gatshme për mirëmbajtje të blera për shkollat e ulëta dhe të mesme të komunave të caktuara dhe paisjet për sallat e edukatës fizike në vlerë prej 724,088€ i kishte regjistruar në regjistrin kontabël të saj si pasuri, në vend që të bëhej bartja e tyre tek komunat-shkollat përkatëse. Pronësia dhe kontrolli i këtyre pasurive realisht ishte te shkollat, respektivisht komunat përkatëse; dhe
- MASHTI investimet/blerjet të cilat kryesisht kishin të bënin me ndërtimin e objekteve shkollore, inventar për universitete dhe paisje të teknologjisë informative nuk kishte arritur t'i regjistronte si pasuri në vijim vlerën 799,889€, duke ndikuar në nënvlerësim të vlerës së pasurive.

Kjo çështje ishte trajtuar edhe në raportin e vitit paraprak dhe menaxhmenti i Ministrisë nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për ta adresuar. Po ashtu, shkak i mos regjistrimit ishte edhe kujdesi jo i duhur i personelit përgjegjës.

Ndikimi

Regjistrimi i pasurive nga ana e MASHTI-it të cilat janë shpërndarë nëpër shkollat e vendit dhe mos bartja e tyre në regjistrat e shkollave (Komunave) që kanë kontrollin dhe pronësinë si dhe mos regjistrimi i pasurive kanë ndikuar që vlera e tyre të mos jetë e saktë duke e mbivlerësuar apo nënvlerësuar pasurinë e Ministrisë.

Rekomandimi B1

Ministrja duhet të ndërmerr veprime konkrete që të siguroj regjistrimin e pasurive dhe që të gjitha pasuritë të cilat janë blerë për shkollat përkatëse, barten me të gjitha procedurat formale në regjistrat e Komunave. Po ashtu, pasuritë e gatshme (paisjet e ndryshme) që blihen për shkolla përkatëse të regjistrohen direkt në regjistrat e shkollave-komunave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve**Gjetja**

Sipas nenit 18, pikës 3 të Rregullës Financiare nr. 01/2013-Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 I UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

MASHTI në vitin 2023 bazuar në planifikimin buxhetor, ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 1,407,566€ në kategori ekonomike jo adekuate.

Pagesat e realizuara nga kategoria e investime kapitale që për nga vlera individuale e pajisjeve dhe natyra e tyre këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime, si në vijim:

- Furnizim me pajisje për sallat e sportit në shkollat e arsimit parauniversitar në vlerë 409,764€;
- Blerjen e pajisjeve për mbrojtjen e objekteve arsimore për qëndrueshmëri dhe blerja e pakove në vlerë 751,055€; dhe
- Furnizim me inventar shkollor në vlerë 151,464€.

Përderisa, Qendra e Studentëve (QS) kishte paguar 95,213€ nga kategoria mallra dhe shërbime për kontratën “Renovimi dhe ri dizajnimi i restorantit dhe kuzhinës së Qendrës së Studentëve” shpenzim i cili për nga natyra i takon kategorisë së investimeve kapitale.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e ndarjes së mjeteve financiare me Ligj të Buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale, pavarësisht kërkesës së MASHTI-t që mjetet për këto projekte të buxhetohen në kategoritë adekuate. Derisa te Qendra e Studentëve mjetet për projektin renovimi i restorantit ishin planifikuar gabimisht si mirëmbajtje e ndërtesave në kategorinë mallra dhe shërbime.

Ndikimi

Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

Rekomandimi B2

Ministrja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime të mëtejme në koordinim me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Mangësi në procesin e vlerësimit të tenderëve

Gjetja

Sipas nenit 40.3 të rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, "Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh.

Ndërsa sipas nenit 59 i Ligjit të Prokurimit Publik nr.04/L-042, thekson se Autoriteti kontraktues (AK) do të konsideroj një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Ne identifikuam se:

- Në aktivitetin e prokurimit "Projektimi i çerdhes tipike të parafabrikuar për 80 fëmijë", vlerësimi i ofertave ishte kryer me 16 ditë vonesë përtej afateve ligjore duke i marrë për bazë edhe afatet shtesë. Procesi i hapjes së ofertave u zhvillua më 17.07.2023, ndërsa vlerësimi u përfundua me 21.09.2023; dhe
- Në dosjen e tenderit "Furnizimin me lëndë të parë dhe paisje të profilit të floktarisë, estetikës për kryerjen e praktikës profesionale", te kapacitetet teknike dhe profesionale është kërkuar që operatorët ekonomik pjesëmarrës të kenë kontrata për furnizime të ngjashme, në tri vitet e shkuara. Nga lista e kontratave të realizuara që kishte ofruar operatori fitues vërehet që furnizimet nuk e kishin natyrën e ngjashme (aktivitet kryesor kishin botimin dhe shtypjen e materialeve). Komisioni i vlerësimit nuk e kishte parandaluar këtë mangësi dhe këtë kriter e kishte konsideruar si të përmbushur. Kontrata ishte lidhur me datë 09.08.2023 në vlerë 117,000€.

Shkaku kryesor i këtyre mangësive ishte mosfunksionimi i kontrolleve të brendshme dhe mungesa e kujdesit të duhur gjatë procesit të vlerësimit dhe dhënies së kontratës.

Ndikimi

Vonesat në vlerësim të tenderëve përveç anashkalimit të rregullave kanë ndikuar edhe në vonesat në lidhje të kontratave e rrjedhimisht në shtyrjen e furnizimeve dhe marrjen e shërbimeve. Po ashtu, vlerësimi jo në përputhje të plotë me kriteret në dosje mund të rezultojë në zgjedhjen e ofertuesve të cilët më pas mund të mos jenë në gjendje të përmbushin detyrimet e kontratës në kohën e duhur dhe me cilësinë e pritur.

Rekomandimi A2

Ministrja duhet të sigurojë një monitorim efektiv përmes menaxherit të prokurimit se vlerësimi i ofertave përfundohet brenda afateve të përcaktuara duke mundësuar që furnizimet të merren në kohën e paraparë. Po ashtu, vlerësimet e ofertave duhet që të realizohen në përputhje të plotë me kriteret për kapacitetet teknike dhe profesionale të kërkuara në dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen) Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Shërbime të veçanta pa procedura të prokurimit**Gjetja**

Neni 57 i rregullores 001/2022 për prokurim publik te pika 57.7 thekson se kontraktimi i konsulentëve individual bëhet përmes procedurave të prokurimit, kontratë publike për shërbime me kriter të shpërblimit “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm”, në varësi të vlerës së parashikuar, Autoriteti Kontraktues përcakton afatet kohore për dorëzim të tenderëve siç përkufizohet në nenin 44 të LPP-së.

Gjatë testimit të tri kontratave me vlerë 8,855€ për shërbime intelektuale këshillëdhënëse në Institutin Albanologjik identifikua se angazhimi për kryerjen e këtyre shërbimeve ishte bërë përmes aktvendimit/kontratës mbi vepër duke anashkaluar konkurrencën e hapur.

Me kontratë mbi vepër ishte angazhuar zyrtari i cili mbante pozitë udhëheqëse në Institut dhe kishte kontratë të rregullt pune. Punët shtesë për të cilat ishte angazhuar kishin të bënin me redaktime kompjuterike, përgatitja e kopertinave dhe skanimi i botimeve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve dhe mos ndjekjes së rregullave të prokurimit për shërbimet e veçanta kontraktuese /intelektuale.

Ndikimi

Angazhimet për shërbime të veçanta duke mos respektuar procedurat e prokurimit publik ndikojnë në eliminimin e konkurrencës dhe rrisin rrezikun që kostoja e këtyre shërbimeve të jetë më e lartë se kostoja e tregut. Po ashtu, kontrata mbi vepër me stafin e angazhuar me kontratë të rregullt nuk jep siguri se proceset po menaxhohen në mënyrë të përgjegjshme.

Rekomandimi A3

Ministrja duhet të ushtrojë kontrolle efektive në Institutin Albanologjik me qëllim që të gjitha shërbimet kontraktuale të zhvillohen përmes procedurave të prokurimit dhe të jenë transparente.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mangësi në pranimin dhe pagesën e furnizimeve**Gjetja**

Sipas nenit 8.4 të Rregullores për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, "Komisioni për Pranimin e Pasurisë jo Financiare ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar dhe të dokumentuar me procesverbal që janë në përputhshmëri me kontratën apo urdhërblerjen. Gjithashtu, sipas nenit 61.19 të RRUOPP, menaxheri i projektit do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë.

Mangësitë ishin si në vijim:

- Sipas kontratës trevjeçare "Furnizimi me pajisje për salla të sportit në shkolla të arsimit para universitar" MASHTI në vitin 2023 ka furnizuar shkollat me pajisje të sportit. Gjatë ekzaminimit fizik në katër (4) shkolla⁵ kemi vërejtur se pozicionet në vlerë 27,951€ nuk ishin realizuar në shkolla siç parashihej me kontratë. Pajiset me vlerë 11,143€ nuk ishin sjellur në shkolla edhe pse të njëjtat ishin paguar sipas raportit nga komisioni i pranimit, derisa paisjet me vlerë 16,808€ ishin sjellur me vonesë apo pas realizimit të pagesës; dhe
- Furnizimet me dollapa në vlerë 11,520€ nuk ishin sipas specifikacioneve në kontratë, sipas kontratës dollapat duhet të ishin me pesë (5) ndarje dhe me çelës derisa të njëjtat nuk i kishin këto karakteristika.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve nga komisionet e pranimit në shkolla dhe nga mungesa e monitorimit të duhur nga menaxheri i kontratës.

Ndikimi

Monitorimi i pamjaftueshëm gjatë pranimit të furnizimeve nga Ministria dhe nga komisionet përkatëse të shkollave mund të ndikoj në mos përmbushjen e objektivave të parapara me këtë kontratë.

Rekomandimi A4

Ministrja duhet të siguroj përmes menaxherëve të kontratave se pagesat realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e furnizimeve të kontraktuara. Po ashtu, për shkollat tjera ku janë kryer furnizimet sipas këtyre kontratave duhet të realizohen vizita nga Ministria (menaxheri i kontratës) për të siguruar që janë kryer të gjitha furnizimet sipas kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2023 ishte 15,323,974€, prej tyre ishin shpenzuar 11,989,079€, ose 78%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me botimet e publikimeve, shërbimet për anëtarësim, shpenzime të pagesave për komunalitë, etj.

Çështja B3 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja

Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja dhe pas pranimit të mallit bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.

Në dhjetë (10) pagesa urdhërblertet ishin bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit dhe pranimit të faturës, vlera e tyre është 279,606€. Vonesat në procedim të urdhërblertjes ishin nga katër ditë deri në gjashtë muaj.

Kjo dukuri ka ndodhur për shkak të angazhimit të pa mjaftueshëm për përgatitjen e urdhërblertjeve dhe zotimeve në kohë.

Ndikimi

Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që ministria mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B3

Ministrja duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojë zbatimin e plotë të procedurave, duke filluar nga iniciimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 21,359,466€, prej tyre ishin shpenzuar 15,785,945€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për ndërtimin e objekteve arsimore, paisjeve të teknologjisë informative, softuer, blerje të inventarit dhe pajisjeve laboratorike, si dhe pajisje për salla sportive.

Çështja A5 - Avancet e hapura për projektet kapitale

Gjetja

Rregullorja 01/2017 për Raportimin vjetor financiar nga OB në nenin 20 thekson raportimin avanseve të paarsyetuara. Ligji i buxhetit të Republikës së Kosovës Nr. 08/L-193, neni 13-pagesat e paradhënies, pika 5 thekson se avancet që kanë të bëjnë me projektet dhe aktivitetet që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë lejohen të mbesin të hapura edhe për vitet pasuese për ato projekte për të cilat liferimi i pajisjeve nuk mund të bëhet brenda një vitit të rregullt fiskal.

Në nenin 20 të PFV-ve në tabelen 2 MASHTI ka prezantuar 11 projekte të papërfunduara që kishin avanse të hapura në vlerë 405,358€, të cilat iu kanë dhënë OE-ve dhe kanë të bëjnë me projekte kapitale për ndërtimin e objekteve arsimore për çerdhe dhe shkolla nga viti 2019 deri 2022. Avancet e hapura nuk kishin të bënin me mbrojtje dhe siguri por ishin për kontratat e objekteve arsimore.

Avancet për projektet kapitale kishin mbetur të hapura ndër vite dhe Ministria nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim konkret që OE-të të arsyetojnë mjetet e marra avanc me realizimin e punëve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i menaxhimit dhe kontroleve jo efektive nga ana e Ministrisë për mbylljen e avanseve në kohën e duhur.

Ndikimi

Vonesat e gjata në realizimin e projekteve kapitale dhe mos mbyllja e avanseve në kohën e duhur ndikojnë që mjetet e avancit të qëndrojnë te operatorët kontraktual duke mos u arritur objektivat.

Rekomandimi A5

Ministrja duhet të sigurohet që avancet për projekte kapitale mbyllen brenda vitit fiskal siç parashihet me rregulla ligjore dhe të monitorohet procesi i avanseve të dhëna për projektet e caktuara. Po ashtu, të specifikohet qartë arsyetimi i tyre për punët e përfunduara që mbulojnë avancet deri në përfundim të vitit fiskal, në mënyrë që të njëjtat mos të mbesin të hapura për vitet në vijim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 125,132,547€, pasurive jokapitale është 3,044,870€, si dhe e stokeve 1,014,803€.

Çështja C1 - Mos bartja e shkollave të ndërtuara tek komunat përkatëse

Gjetja

Sipas nenit 13, pikes 1 dhe 2 të rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, të gjitha transaksionet e krijuara gjatë ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim dhe në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyllë llogarinë e investimeve në vijim.

Ne identifikuam që në vitin 2023 kishte filluar bartja e shkollave të komunat përkatëse dhe brenda vitit kishte arritur të barte 19 shkolla. Megjithatë ende ka shkolla të cilat janë përfunduar por nuk janë bartur edhe pse këto shkolla i plotësonin kriteret për zhvillimin e procedurave për dorëzim tek Komunat përkatëse dhe regjistrimin e tyre si objekte në përdorim. Bartja nuk kishte ndodhur dhe ato mbaheshin ende në regjistrat e MASHTI-it si investime në vijim.

Vonesat në transferimin e pasurive nga MASHTI te Komunat përkatëse ishte një dukuri që përsëritet për vite me radhë, megjithatë është inkurajuese që gjatë vitit 2023 kishin filluar të bëjnë bartjen tek Komunat përkatëse. Ministria ka filluar të ndërmerë veprime, por sipas tyre mungesa e burimeve njerëzore në dispozicion, ishte shkak që këto procedura për dorëzimin-bartjen e shkollave të marrin kohë më të gjatë se viti fiskal.

Ndikimi

Mos bartja e plotë e objekteve arsimore ka efekt negativ në menaxhimin e tyre nga organizata që në realitet e ka kontrollin mbi to.

Rekomandimi C1

Ministrja duhet të shqyrtoj mundësinë e themelimit të një komisioni për të trajtuar të gjitha objektet arsimore të financuara nga Ministria të cilat i kanë plotësuar kushtet për dorëzim- bartje te Komunat përkatëse. Po ashtu, të bëhen procedurat formale të bartjes dhe në bashkëpunim me Thesarin, regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim të kalojë në regjistrat e Komunave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	82,799,243	77,903,348	68,013,651	69,875,116	63,934,474
Grante Qeveritare – Buxheti	80,429,518	73,024,333	65,920,068	68,084,878	61,699,055
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	112,958
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,445,927	968,848	526,369	413,289
Të hyrat vetanake	2,369,725	2,369,725	625,955	522,320	890,698
Donacionet vendore	0	14,901	7,220	64,595	105,389
Donacionet e jashtme	0	1,048,463	491,561	676,955	713,085

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 4,895,895€. Ky zvogëlim është rezultat i mos shpenzimit të buxhetit dhe kërkesës së MASHTI-it për kursime dhe vendimeve nga Qeveria.

Në vitin 2023 MASHTI ka shpenzuar 87% të buxhetit final ose 68,013,981€, me një rritje prej 2% në krahasim me vitin 2022.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	82,799,243	77,903,348	68,013,651	69,875,116	63,934,474
Pagat dhe mëditjet	21,811,370	21,531,127	21,293,577	20,851,630	20,345,560
Mallrat dhe shërbimet	17,380,000	13,638,968	10,828,658	28,161,093	22,554,296
Komunalitë	1,590,459	1,685,005	1,160,090	1,088,348	1,032,583
Subvencionet dhe transferet	6,805,360	19,688,782	18,945,381	6,211,841	4,585,831
Investimet Kapitale	35,212,054	21,359,466	15,785,945	13,562,204	15,416,203

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 280,243€. Ky zvogëlim ishte me vendime të Qeverisë për tërheqjen e mjeteve të kursyera, të pa shpenzuara nga kjo kategori. Shpenzimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 99%;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 3,741,485€ me vendime të Qeverisë, pas kërkesës së MASHTI-it që pagesa e librave shkollor për klasat 1-9 të bëhet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve. Shpenzimi i buxhetit për këtë kategori ishte 79%;
- Buxheti final për komunalitë ishte rritur për 94,546€. Shpenzimi nga buxheti për këtë kategori ishte 69%;
- Buxheti për kategorinë e subvencione dhe transfere është rritur për 12,883,422€, nga i cili ishin shpenzuar 96%. Rritja e buxhetit në këtë kategori kishte të bënte me subvencionimin për blerjen e librave shkollor dhe paisjeve të tjera shkollore. Nga kjo kategori, po ashtu ishin subvencionuar edhe bursat e studentëve dhe OJQ-të; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 13,852,588€, si rezultat i mos shpenzimit të fondeve. Shpenzimet krahasuar me buxhetin final ishin 74%. Realizimi i buxhetit në këtë nivel ishte si rezultat i menaxhimit jo të duhur të kontratave dhe vonesave në përmbushjen e kontratave gjatë realizimit të projekteve të planifikuara.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga MASHTI në 2023 ishin në vlerë 2,364,692€. Ato kanë të bëjnë me participimet, tarifat për akreditim, taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme, etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	2,849,507	2,849,507	2,364,692	2,736,910	2,434,375
Të hyrat jo tatimore	2,849,507	2,849,507	2,352,586	2,699,268	2,414,044
Të hyrat tjera	0	0	12,107	37,642	20,331

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2022 të MASHTI-t ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, tri (3) rekomandime ishin zbatuar, një (1) ishte zbatuar pjesërisht ndërsa tri (3) nuk ishin zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministrja duhet të shqyrtoj mundësinë për rritjen e burimeve për menaxhimin e pasurive dhe të siguroj se të gjitha pasuritë e regjistruara të cilat janë blerë për shkollat përkatëse, barten me të gjitha procedurat formale në regjistrat e komunave. Po ashtu, duhet të korrigjohen të gjitha gabimet e identifikuara në regjistrat kontabël të pasurive.	Edhe gjatë vitit 2023 kemi hasur në pasuri të cilat nuk janë bartur tek komunat përkatëse, po ashtu blerje të vitit të cilat nuk ishin përfshirë në regjistrin e pasurisë.	Nuk ka filluar zbatim
2.	Baza për opinion	Ministrja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime të mëtejme në koordinim me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Pavarësisht kërkesave nga MASHTI për ndarjen e buxhetit në kategorinë adekuate vërehet se kjo nuk kishte ndodhur nga Kuvendi i Kosovës. Edhe gjatë vitit 2023 kemi hasur në raste të keqklasifikimit.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të sigurojë se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit në mënyrë që të shmangen kostot shtesë si pasojë e pagesave me procedura përmbartimore apo gjyqësore.	Në pagesat e testuara janar-shkurt 2024 për obligimet e papaguara të viti 2023 nuk kemi hasur në dukuri të cilat kishin të bënin me vonesa në pagesën e faturave më shumë se 30 ditë.	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojë zbatimin e plotë të procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.	Edhe gjatë vitit 2023 kemi hasur në raste të njëjta, mirëpo vlera e tyre nuk ka ndikim në opinionin e pajtueshmërisë.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit, rastet kur paraqiten vonesa në realizimin e projekteve dhe aprovohet zgjatja e afateve për përmbushjen e kontratave, kjo të përcjellet edhe me sigurinë e ekzekutimit sipas afateve të reja të kontratës.	Nuk kemi hasur në çështje të tillë.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Ministrja duhet të shqyrtoj mundësinë e themelimit të një komisioni për të trajtuar të gjitha objektet arsimore të financuara nga Ministria të cilat i kanë plotësuar kushtet për dorëzim- bartje te Komunat përkatëse. Po ashtu, të bëhen procedurat formale të bartjes dhe në bashkëpunim me Thesarin regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim të kalojë në regjistrat e Komunave.	Gjatë vitit 2023 kishin filluar të bëjnë bartjen tek Komunat përkatëse, mirëpo numri i lartë i tyre dhe mungesa e burimeve njerëzore në dispozicion nuk kishte arritur që ta finalizonte këtë proces.	Pjesërisht i zbatuar
7.	Obligimet e papaguara	Ministrja duhet të siguroj një kontroll efektiv të obligimeve që rrjedhin nga aktiviteti i Ministrisë në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar për të shmangur penalizimet për shkak vonesave.	Gjatë vitit 2023 nuk kemi hasur në pagesa që ishin realizuar përmes thesarit, duke krijuar shpenzime shtesë për faturat e papaguara.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Kreshnike Haziri-Bublica, Udhëheqëse e ekipit



Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



Luljeta Sylaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	Gjate planifikimit të buxhetit gjithmonë është trajtuar dhe adresuar e gjetura e ZAP-it sa i përket keqë klasifikimit të projekteve kapitale dhe bartjes së tyre tek kategoria e mallëra dhe shërbimeve. Gjate planifikimit të buxhetit, ne prap kemi adresuar kërkesën së bashku me materialin e planifikimit të Qarkores së parë buxhetore 2024/01 dhe 02 ne muajin korrik me datën: 13.07.2023 dhe në tetor me datën: 20.10.2023. Shkresa pas dëgjimeve buxhetore të dorëzuar në MFPT për bartjen e këtyre projekteve me datën: 29.09.2023 si dhe KASH-I 2025/27 13.03.2024. Ndërsa shkresa e fundit është dorëzuar edhe me: 11.06.2024. Pas gjitha këtyre kërkesave, nuk është realizuar ende nga MFPT. Sipas Udhëzimit Administrativ MF - NR.04/2019 për definimin e projekteve kapitale dhe klasifikimin e shpenzimeve të projekteve kapitale, neni 4, ku janë të përcaktuar kriteret dhe karakteristikat për një projekt kapital, Qendra e Studentëve, ka vlerësuar që “Renovimi dhe ri dizajnimi i restorantit dhe kuzhinës së Qendrës së Studentëve” nuk i përmbush kriteret e një projektit kapital. Nuk ka pasur as ndryshim/zgjerim të hapësirës së brendshme apo të jashtme të objektit, as rritje të kapacitetit të sallës ku ushqehen studentët, dhe as një pajisje apo ekuiment që ka kushtuar mbi 1000 euro. Sipas specifikave të punimeve të kryera, shihet që asnjë pozicion nuk ka pasur vlerën për njësi mbi 1000 Euro, dhe kemi pasur të bëjmë vetëm me punë renovuese sic është emërtimi I projektit dhe jo ndonjë investim kapital. Për më tepër personalisht në takimin me Thesar dhe USAID me rastin e ndryshimit Planit Kontabel për vitin 2024, kam adresuar këtë pyetje dhe më është përgjigjurur që Investim Kapital konsiderohet vetëm atëherë kur kemi të bëjmë Një investim afatgjatë që përdoret për të ndërtuar, rritur ose zgjeruar kapacitete, kurse shpenzim që lidhet me menaxhimin, riparimin, mirëmbajtjen apo aktivitetet minore të asetit, nuk konsiderohet si Investim Kapital. Po ashtu ju njoftoj që në të gjitha proceset të planifikimit buxhetor vjetor ne dokumentin PCF, si dhe në planifikimi përfundimtar të prokurimit vjetor Mirëmbajtja ndërtesave të QS (8 Konvikte,	Në raport ne kemi theksuar edhe përpjekjet e MASHTI-it që disa projekte të financohen/buxhetohen te kategoria mallra dhe shërbime, mirëpo fakti që kjo nuk ka ndodhur dhe shpenzimet (keq klasifikimet) janë pjesë e PFV-ve të MASHTI-it, sipas standardeve të auditimit duhet të paraqiten në Raportin e auditimit të OB-së ku ka ndodhur shpenzimi. Po ashtu, kjo çështje do të adresohet edhe në Raportin Vjetor të Buxhetit të Qeverisë Buxhetit të Qeverisë. Bazuar në përmbajtjen dhe vlerën e kontratës (vlera e kontratës 237,706€) vërehet se kemi të bëjmë me një kontratë pune që bënë intervenime përmbajtësore në objekt duke i shtuar (kapitalizuar) vlerën e saj. Pra me këtë kontratë nuk kemi të bëjmë me mirëmbajtje rutinore e cila i përmbushë kriteret për tu paguar nga kategoria mallra dhe shërbime. <i>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</i>

	Sala 1 Tetori, Mensën e Studentave) janë shpenzime që planifikohen në Mallra dhe Sherbime, në kodin 1400 Mirëmbajtja.	
Mangësi në procesin e vlerësimit të tenderëve	Në harmoni me nenin 40.3 të Rregullores me nr. 001/2022 për Prokurim Publik, e hyr në fuqi me datë 20.10.2022, përcakton afatin e vlerësimit të tenderit, por jo edhe të konkursit të projektimit. Procedurat e konkursit të projektimit, janë të rregulluara me nenin 55 të Rregullores me nr. 001/2022 për Prokurim Publik, të datës 20.10.2022. Aktiviteti i prokurimit "Projektimi i çerdhes tipike të parafabrikuar për 80 fëmijë" është zhvilluar përmes procedurës së prokurimit "Konkurs Projektimi", e cila procedure është e veçantë nga procedurat e tjera të prokurimit. Dallimi i kësaj procedure të prokurimit nga procedurat e tjera, është, si për nga mënyra e dorëzimit të ofertave, pasi që dorëzimi i tyre bëhet në formë fizike, ashtu edhe për nga mënyra e vlerësimit të tyre. Vlerësimi i konkursit të projektimit bëhet në dy faza: nga dy komisione të ndryshme: Njëri komision është JURI PROFESIONALE, ndërsa komision tjetër është KOMISION I VLERËSIMIT ADMINISTRATIV të ofertave, i cili komision formohet dhe e fillon punën pasi që të përfundon vlerësimi nga juria profesionale. Të dy komisionet formohen me vendime të veçanta, dhe secili nga komisionet përfundon punën me raport të vlerësimit, në kohë të ndryshme. Pas përfundimit të punës së njërit komision, formohet komisioni tjetër me vendim. Kjo procedure e prokurimit është mjaftë komplekse. Si do që të jetë, vlerësimi nga juria profesionale, ashtu edhe nga komisioni i vlerësimit të konkursit të projektimit nuk është bërë vonesë, pasi që secili komision nuk është vonuar mbi 30 ditë kalendrike nga emërimi i tyre. Në vijim, gjeni një përshkrim kronologjik se si është bërë vlerësimi i këtij konkursi të projektimit: • Pranimi i ofertave – projekteve është bërë me datën 17.07.2023 • Vlerësimi nga juria profesionale është përfunduar me datë 11.08.2023 • Hapja financiare është bërë me datë 15.09.2023 • Përfundimi i vlerësimit administrativ është bërë me datë 21.09.2023 Në bazë të kësaj që u cek më lartë, konsiderojmë se kjo e gjetur nuk qëndron, pasi që nuk është bërë me vonesë vlerësimi e konkursi të projektimit në fjalë.	Nga komentimi i ofruar në lidhje me çështjen e trajtuar nuk kemi ofruar argumente nëse për konkurse të projektimit nuk vlejnë afatet e njëjta kohore siç është e definuar në nenin 40.3 të Rregullores me nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Bazuar në nenin 73 të LPP të pikës 2 theksohet se 2. "Konkursi i projektimit do të ushtrohet në të njëjtën mënyrë, dhe me të njëjtat afate kohore siç ushtrohen aktivitetet e prokurimit për kontratat me vlerë të madhe që zbatojnë procedurat e hapura ose të kufizuara" <i>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</i>

Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRASHUTIM/PROZVORJE: 20-06-2024			
Nr. Org. / Org. Unit	Shif. Klasif. / Class. Code	Nr. Prot. / Br. Prot.	Nr. i faqeve / Br. Stranica
03	47	908	1



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE I TEKNOLOGJISË	
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEKNOLOGIJE	
SEKTORI I ARHIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Nr. Org. / Org. Unit	Nr. Prot. / Br. Prot.
0113	1320
Nr. i faqeve / Br. Stranica	Datum / Date
1	20.06.24
Prishtinë / Pr	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije - Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

LETËR KONFIRMIMI

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit**, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Dëshmitë dhe komentet në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e raportit ju kemi përcjellë përmes e- mailit zyrtar;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Arbërie Nagavci


Prishtinë

Ministër e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Data: 18 qershor 2024,

Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Furnizimet ishin bërë për shkollat: Salla e edukatës fizike në "Pjetër Bogdani" në Ferizaj, "Dëshmorët e Greigovcit" në Suharekë, "Skender Luarasi" në Suharekë, "Jeronim De Rada" në Ferizaj, "Abdurrahman Gërguri, në Obiliq, gjimnazi" Gjergj Kastrioti-Skenderbeu" në Glogovc, "Ibrahim Mazdreku" në Obiliq, "Fazli Grajqevci" në Mitrovicë, "Migjeni në Mitrovicë, "Tefik Çanga" në Ferizaj, "Bajram Curri", në Prizren, "Luigj Gurakuqi", në Klinë, " Tre dëshmorët e shkollës shqipe" në Istog, "Abedin Bujipi", në Drenas, "Selami Hallaqi" në Gjiilan, "Rexhep Elmazi" në Gjiilan, "Xheladin Deda" në Mitrovicë, "Arkitekt Sinani" në Mitrovicë, "Ismail Qemali" në Mitrovicë, "Skenderbeu" në Shtime, "Naim Frashëri" në Podujeve, "Dëshmorët e Kombit" në Kamenicë, "Xhemajl Mustafa" në Prishtinë, "Emin Duraku" në Shtime, "Thimo Mitko" në Gjiilan, "Gjon Serreqi" në Ferizaj, " Dëshmorët e kombit" në Kamenicë, "Naim Frashëri" në Ferizaj, "Zenel Hajdini" në Lipjan, "Fazli Grajqevci" në Mitrovicë, "Zekeria Rexha" në Gjakovë, "Azem Bejta" në Klinë
- ⁶ Salla e edukatës fizike në SHFMU "Fazli Grajqevci" në Mitrovicë, Salla e edukatës fizike në SHFMU "Migjeni" në Mitrovicë, Salla e edukatës fizike në SHFMU "Ibrahim Rugova" në Mazgit I Ulët dhe Salla e edukatës fizike "Abdurrahman Gërguri" në Dardhishtë)
- ⁷ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.